

[ALBANIAN TEXT — TEXTE ALBANAIS]

MARREVEESHJE NDERMJET QEVERISE SE MBRETERISE SE BASHKUAR TE BRITANISE SE MADHE DHE TE IRLANDES SE VERIUT DHE QEVERISE SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE, PER NXITJEN DHE MBROJTJEN E INVESTIMEVE

Qeveria e Mbreterise se Bashkuar te Britanise se Madhe dhe Irlandes se Veriut dhe Qeveria e Republikes se Shqiperise;

Duke dëshiruar te krijojne kushte te favorshme per investime me te medha, nga shtetas dhe shoqeri te njerit shtet ne territorin e shtetit tjetere;

Duke njohur qe inkurajimi dhe mbrojtja e ndersjellte sipas nje marreveshje nderkombetare te investimeve te tilla do te sjelle si pasoje stimulimin e nismes private te biznesit dhe do te rrise begatine ne te dy shtetet;

u muaren vesh per sa vijon:

NEINI 1**Perkufizime**

Per qellimet e kesaj Marreveshjeje:

- (a) Me "investim" kuptohet cdo lloj pasurie dhe ne vecanti, megjithese jo ekskluzivisht, perfshihet:
 - (i) pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme dhe cdo e drejte tjeter pasurore, sic eshte hipotekimi, pengjet, huate ose garancite;
 - (ii) aksionet ne burse dhe detyrimet ne nje shoqeri dhe cdo forme tjeter te pjesemarrjes ne nje shoqeri;
 - (iii) e drejta mbi nje sasi parash ose tek cdo veprim sipas kontrates qe ka vlere financiare;
 - (iv) te drejttat e pronesise intelektuale, klientela, proceset teknologjike dhe know - how;
 - (v) koncesionet ne biznes te parashikuara nga ligji sipas kontrates, perfshire koncesionet per kerkim, perpunim, nxjerrje ose shfrytezim te burimeve natyrore;

Ndryshimi i formes ne te cilen pasurite jane investuar nuk ndikon ne karakterin e tyre si investime dhe termi "investim" perfshin te gjitha investimet, te bera para ose pas dates te hyrjes ne fuqi te kesaj marreveshjeje.

- (b) me "te ardhurat nga fitimet" kuptohen shumat e vjelura nga nje investim dhe ne vecanti, megjithese jo ekskluzivisht, perfshihen fitimi, interesat, rritjet e kapitalit, dividendet, perqindjet nga perdorimi i patentes, pagesa per disa tipe konsultimi.
- (c) me "shtetas" kuptohet:
- (i) ne Mbreterine e Bashkuar: personat fizike statusi i te cileve buron nga te qenit shtetas te Mbreterise se Bashkuar sipas ligjit ne fuqi ne Mbreterine e Bashkuar;
- (ii) ne Republiken e Shqiperise: personat fizike statusi i te cileve buron nga te qenit shtetas te Republikes se Shqiperise, sipas ligjit ne fuqi ne Shqiperi;
- (d) me "shoqeri" kuptohet:
- (i) ne rastin e Mbreterise se Bashkuar: korporatat, firmat dhe shoqerite e formuara ose te krijuara sipas ligjit ne fuqi ne cdo pjese te Mbreterise se Bashkuar, ose ne cdo territor ne te cilin vepron kjo Marreveshje, ne perputhje me dispozitat e Nenit 12;
- (ii) ne rastin e Republikes se Shqiperise: personat juridike qe perfshijne korporatat, firmat dhe shoqerite e formuara ose te krijuara sipas ligjit ne fuqi ne Shqiperi;
- (e) me "territor" kuptohet:
- (i) ne Mbreterine e Bashkuar: Britania e Madhe dhe Irlanda e Veriut, duke perfshire ujrat territoriale dhe cdo zone bregdetare te vendosur pertej ujrave territoriale te Mbreterise se Bashkuar, e cila ka gene ose mund te percaktohet ne te ardhmen sipas ligjit kombetar te Mbreterise se Bashkuar ne perputhje me te Drejten Nderkombetare si nje zone brenda se ciles Mbreteria e Bashkuar mund te ushtroje te drejta sa i perket nendetit dhe nentokes dhe burimeve natyrore, dhe cdo territor ne te cilin vepron kjo Marreveshje ne perputhje me dispozitat e Nenit 12;
- (ii) ne Republiken e Shqiperise: territori i Shqiperise duke perfshire ujrat territoriale dhe cdo zone bregdetare te vendosur pertej ujrave territoriale te Shqiperise, e cila ka gene ose mund te percaktohet ne te ardhmen sipas ligjit kombetar te Shqiperise ne perputhje me te Drejten Nderkombetare si nje zone brenda se ciles Shqiperia mund te ushtroje te drejta, sa i perket nendetit dhe nentokes dhe burimeve natyrore.

NENI 2

Nxitja dhe Mbrojtja e Investimeve

- (1) Secila Pale Kontraktuese do te inkurajoje dhe krijoje kushte te favorshme per shtetasit ose shoqerite e Pales tjeter Kontraktuese, per te investuar kapital ne territorin e saj dhe ne baze te se drejtes se saj per te ushtruar fuqine sipas ligjeve te saj, do te lejoje nje kapital te tille.
- (2) Investimet e shtetasve ose te shoqerive te seciles Pale Kontraktuese do t'i nenshtrohen ne cdo kohe nje trajtimi te drejte e te barabarte, dhe do te gezojne mbrojtjen e sigurte e te plote ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese. Asnjera prej Paleve Kontraktuese ne asnje menyre, nuk do te demtoje nepermjet masave te paaresyeshme dhe diskriminuese administrimin, ruajtjen, perdorimin, zoterimin ose dhenien apo shitjen e investimeve ne territorin e saj, te shtetasve ose shoqerive te Pales tjeter Kontraktuese. Secila Pale Kontraktuese do te respektojte cdo detyrim qe mund te kete lidhur me investimet e shtetasve ose shoqerive te Pales tjeter Kontraktuese.

NENI 3

Trajtimi Kombetar dhe Dispozitat e Kombit me te Favorizuar

- (1) Asnjera nga Palet Kontraktuese nuk do te trajtoje ne territorin e saj, shtetasit ose shoqerite e Pales tjeter Kontraktuese persa i perket administrimit, ruajtjes, perdorimit, zoterimit ose dhenies apo shitjes se investimeve te tyre, ne menyre me pak te favorshme se sa ai qe i akordohet shtetasve apo shoqerive te saj apo shtetasve ose shoqerive te cdo vendi te trete.
- (2) Asnjera nga Palet Kontraktuese ne territorin e saj nuk do t'i jape ne territorin e saj shtetasve ose shoqerive te Pales tjeter Kontraktuese nje trajtim me pak te favorshem persa i perket administrimit, ruajtjes, perdorimit, zoterimit ose dhenies ose shitjes se investimeve te tyre, sesa ai akorduar shtetasve ose shoqerive te cdo vendi te trete.
- (3) Per shmangien e dyshimit konfirmohet qe trajtimi i siguruar ne paragrafet (1) dhe (2), si me siper do te zbatohet tek dispozitat e neneve 1 deri 11 te kesaj Marreshjeje.

NENI 4**Kompensimi per humbjet**

- (1) Shtetasve ose shoqerive te nje Pale Kontraktuese, investimet e te cileve ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese pesojne humbje per shkak te luftes ose ndonje konflikti tjeter te armatosur, revolucioni, gjendje te jashtezakonshme kombetare, revolte, kryengritje ose trazire ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese, do t'u akordohet nga Pala tjeter Kontraktuese nje trajtim per kthimin ne gjendjen e meparshme, demshperblimin, kompensimin ose zgjidhje te tjera, jo me pak i favorshem sesa ai qe Pala tjeter Kontraktuese u akordon shtetasve ose shoqerive te saj ose shtetasve ose shoqerive te cdo vendi te trete. Pagesat rezultuese do te jene lirisht te transferueshme.
- (2) Pa cenuar paragrafin (1) te ketij neni, shtetasve dhe shoqerive te njeres Pale Kontraktuese te cilet ne ndonje nga situatat referuar ketij paragrafi (paragrafi 1) pesojne humbje ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese, qe rezultojne nga :
 - (a) rekuizimi i pasurise se tyre nga forcat apo autoritetet e saj, ose :
 - (b) shkaterrimi i pasurise se tyre nga forcat apo autoritetet e saj, i cili nuk eshte shkaktuar ne veprim luftimi ose nuk ka gene i kerkuar nga nevoja e situates, do t'u akordohet kthimi ne gjendjen e meparshme ose kompensimi i mjaftueshem. Pagesat rezultuese do te jene lirisht te transferueshme.

NENI 5**Shpronesimi**

- (1) Investimet e shtetasve ose shoqerive te seciles Pale Kontraktuese nuk do te shtetezohen, shpronesohen ose nuk do t'u nenshtrohen masave qe kane efekt te njejte me shtetezimin dhe shpronesimin (ketu e me tej te quajtura "shpronesim") ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese, pervec se per nje qellim publik qe lidhet me nevoja te brendshme te kesaj Pale Kontraktuese mbi baza jo diskriminuese dhe perkundrejt kompensimit te shpejte, te mjaftueshem dhe efektiv.

Nje kompensim i tille do te jete i barabarte me vleren e vertete te investimit te shpronesuar, menjehere perpara shpronesimit ose perpara se shpronesimi potencial te behet publik, e cilido qe eshte me i pari, do te perfshije interesin ne nje kurs tregtar normal deri ne daten e pageses, do te behet pa vonese, te jete efektivisht i realizueshem dhe lirisht i transferueshem. Shtetasi ose shoqeria e prekur, do te kete te drejten sipas ligjit te

Pales Kontraktuese qe ben shpronosimin, per nje shqyrtim te shpejte nga nje autoritet juridik ose ndonje autoritet tjeter i pavarur i kesaj Pale Kontraktuese, te rastit te tij ose te saj dhe te vleresimit te investimit te tij ose te saj ne perputhje me parimet e formuluar ne kete paragraf.

- (2) Atje ku nje Pale Kontraktuese shpronoson pasurite e nje shoqerie e cila eshte e formuar ose e krijuar, sipas ligjit ne fuqi ne cdo pjese te territorit te saj, dhe ne te cilen shtetasit ose shoqerite e Pales tjeter Kontraktuese jane pronare aksionesh, ajo do te siguroje dispozitat e paragrafit (1) qe garanton kompensim te shpejte, te mjaftueshem dhe efektiv lidhur me investimet e tyre, te shtetasve apo shoqerive te Pales tjeter Kontraktuese qe jane pronare te ketyre aksioneve.

NENI 6

Riatdhesimi i Investimeve dhe te Ardhurave.

Cdo Pale kontraktuese persa i perket investimeve do t'u garantoje shtetasve ose shoqerive te Pales tjeter Kontraktuese nje transferim te lire te investimeve dhe te ardhurave te tyre. Transferimi do te kryhet pa vonese, ne valuten lirisht te konvertueshme ne te cilen fillimisht eshte investuar kapitali ose ne ndonje valute tjeter te konvertueshme per te cilen bihet dakort midis investitorit dhe Pales Kontraktuese te interesuar. Derisa te mos bihet dakort ndryshe nga investitori, transferimet do te behen ne kursin e kembimit te zbatueshem ne daten e transferimit ne perputhje me rregullat e kembimit ne fuqi.

NENI 7

Perjashtime

Dispozitat e kesaj marreveshjeje per dhenien e trajtimit jo me pak te favorshem sesa ai i akorduar per shtetasit apo shoqerite e seciles Pale Kontraktuese ose te ndonje shteti te trete nuk do te interpretohen ne menyre te tille qe te detyrohet njera Pale Kontraktuese t'u ofroje shtetasve ose shoqerive te Pales tjeter Kontraktuese favorin e cdo trajtimi, preference ose privilegji qe rezulton nga:

- (a) cdo bashkim doganor ekzistues ose i ardhshem, ose nga cdo marreveshje nderkombetare e perafert, tek e cila secila Pale Kontraktuese eshte ose mund te behet Pale;
- (b) cdo marreveshje nderkombetare ose rregulla qe lidhen teresisht ose kryesisht me taksimin ose me cdo legjislacion vendas qe lidhet teresisht ose kryesisht me taksimin.

NENI 8

Per Qendren Nderkombetare per Zgjidhjen
e Mosmarreveshjeve per Investimet

- (1) Per kete aresye cdo Pale Kontraktuese lejon t'i nenshtrohet Qendres Nderkombetare per Zgjidhjen e Mosmarreveshjeve per Investimet (ketu e me tej e quajtur "Qender") per zgjidhjen me pajtim ose arbitrazh sipas Konventes mbi Zgjidhjen e Mosmarreveshjeve per Investimet midis shteteve dhe shtetasve te shteteve te tjere e hapur per nenshkrim ne Washington me 18 Mars 1965 per cdo mosmarreveshje legale te lindur midis kesaj Pale Kontraktuese dhe nje shtetasi ose shoqerie te Pales tjeter Kontraktuese, lidhur me nje investim te njeres Pale Kontraktuese ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese.
- (2) Nje shoqeri e cila eshte formuar ose krijuar sipas ligjit ne fuqi, ne territorin e nje Pale Kontraktuese dhe ne te cilen, perpara se te lindete nje mosmarreveshje e ketille, pjesa kryesore e aksioneve jane prone e shtetasve ose shoqerive te Pales tjeter Kontraktuese do te trajtohet ne perputhje me Nenin 25 (2)(b) te Konventes, per qellimet e Konventes si nje shoqeri e Pales tjeter Kontraktuese.
- (3) Ne qofte se do te linde ndonje mosmarreveshje e tille dhe ajo nuk do te zgjidhet brenda nje periudhe prej 3 muajve me ane te mjeteve lokale, ose ne rast te kundert, ne qofte se shtetasi ose shoqeria e prekur nga ajo, bien dakort me shkrim t'ia kalojne ate Qendres per ta zgjidhur nepermjet pajtimit apo arbitrazhit mbi bazen e Konventes, atehere secila Pale Kontraktuese mund te filloje procedurat me adresimin e nje kerkese te tille, Sekretarit te Pergjithshem te Qendres, sic eshte parashikuar ne nenet 28 dhe 36 te Konventes.

Ne rast mosmarreveshjeje, ne rast se nuk bihet dakort se cila eshte procedura me e pershtatshme pajtimi apo arbitrazhi, atehere eshte e drejta e shtetasit apo shoqerise se prekur te zgjedhe njerin nga te dyja. Pala Kontraktuese, e cila eshte Pale ne mosmarreveshje nuk do te ngreje si kundersiztim ne cdo shkalle te procedurave ose si detyrim te nje vendimi gjyqi, faktin qe shtetasi ose shoqeria, te cilet jane Pala tjeter ne mosmarreveshje kane marre ne perputhje me nje kontrate sigurimi, nje shperblim persa i perket disa ose te gjitha humbjeve te tij ose te saj.

- (4) Asnjera nga Palet Kontraktuese nuk do te ndjeke nepermjet kanaleve diplomatike cdo mosmarreveshje referuar Qendres derisa:
 - (a) Sekretari i Pergjithshem i Qendres, ose nje Komision pajtimi ose nje gjykate arbitrazhi e caktuar nga ajo, te vendosi qe mosmarreveshja nuk eshte brenda juridiksionit te Qendres, ose

- (b) Pala tjetër Kontraktuese nuk do të arrijnë për t'ju përmbajtur ose për të zbatuar çdo vendim gjyqi të dhënë nga një gjykatë arbitrazhi.

ENI 9

Mosmarreveshjet midis Paleve Kontraktuese

- (1) Mosmarreveshjet midis Paleve Kontraktuese për interpretimin ose për zbatimin e kësaj marreveshjeje do të zgjidhen nëse është e mundur nëpërmjet kanaleve diplomatike.
- (2) Nëse një mosmarreveshje midis Paleve Kontraktuese nuk mund të zgjidhet në këtë mënyrë, ajo do t'i nënshtrohet një gjykatë arbitrazhi, në bazë të kërkesës së çdonjëres nga Palet Kontraktuese.
- (3) Një gjykatë e tillë arbitrazhi do të formohet për çdo rast të vecantë në mënyrën si më poshtë. Brenda dy muajve nga marrja e kërkesës për arbitrazh, çdo Pale Kontraktuese do të emerohet një anëtar të gjykatës. Këta dy anëtarë më pas do të zgjedhin një shtetas të një shteti të tretë, i cili më miratim nga të dyja Palet Kontraktuese do të emerohet Kryetari i Gjykatës. Kryetari do të emerohet brenda dy muajve nga data e emerimit të dy anëtarëve të tjerë.
- (4) Në qoftë se brenda afatit të paracaktuar në paragrafin (3) të këtij eni nuk janë bërë emerimet e nevojshme, secila Pale Kontraktuese në mungesë të ndonjë marreveshjeje tjetër, mund të ftojë Presidentin e Gjykatës Nderkombëtare të Drejtësisë për të bërë çdo emerim të nevojshëm.

Nëse Presidenti është nënshtetas i ndonjëres nga Palet Kontraktuese ose nëse ai në të kundërtën është i ndaluar të kryejë funksionin e mesipër, zv/presidenti do të ftohet për të bërë emerimet e nevojshme. Nëse ky i fundit është një shtetas i ndonjëres prej Paleve Kontraktuese ose nëse ai gjithashtu është i ndaluar për kryerjen e funksionit të sipërpermendur, anëtari i Gjykatës Nderkombëtare të Drejtësisë, më vjetërsi punë me të madhe dhe që nuk është shtetas i ndonjëres Pale Kontraktuese, do të ftohet për të bërë emerimet e nevojshme.

- (5) Gjykata e Arbitrazhit do të marrë vendimin e saj me shumicë votash. Një vendim i tillë do të jetë i detyrueshëm për të dyja Palet Kontraktuese. Secila prej tyre do të përballojë shpenzimet e anëtarit të saj në gjykatë dhe të perfagesuesit të saj në procedurat e arbitrazhit; shpenzimet e Kryetarit dhe ato mbetese do të përballohen në pjesë të barabarta, nga Palet Kontraktuese. Megjithatë Gjykata, në vendimin e saj mund të urdherojë që një pjesë më e madhe e shpenzimeve të përballohet nga njëra prej Paleve Kontraktuese, dhe ky vendim gjyqësor do të jetë i detyrueshëm për të dyja Palet Kontraktuese.

Gjykata do të vendosë se çfarë procedure do të ndjekë.

NENI 10

Subrogimi

(Zevendesimi i nje personi apo nje subjekti me nje tjeter sipas nje kerkese te ligjshme ose zbatimi me te drejta te plota).

- (1) Nese nje Pale Kontraktuese ose Agjensi e caktuar e saj ("Pala e pare Kontraktuese") ben nje pagese sipas nje garancie te dhene sa i perket nje investimi ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese ("Pala e dyte Kontraktuese"), Pala e dyte Kontraktuese do te pranoje:
 - (a) dhenien Pales se pare Kontraktuese nepermjet ligjit ose nepermjet nje transaksioni ligjor te te gjitha te drejtave dhe pretendimeve te Pales Kontraktuese te garantuar, dhe
 - (b) qe Pales se pare Kontraktuese i eshte dhene e drejta te ushtroje te tilla te drejta dhe te mbeshtese te tilla pretendime ne baze te subrogimit ne te njejten mase sa Pala Kontraktuese e siguruar.
- (2) Pales se pare Kontraktuese do t'i jepet e drejta ne te gjitha rrethanat te kete te njejtin trajtim sa i perket:
 - (a) te drejtave dhe pretendimeve te fituara ne baze te emerimit, dhe
 - (b) cdo pagese te marre ne perputhje me keto te drejta dhe pretendime dhe meqe Pales se siguruar (per cdemtim) i eshte dhene e drejta te marre (te perfitoje), ne baze te kesaj marreveshjeje sa i perket investimit perkates dhe te ardhurave te saj respektive.
- (3) Cdo pagese e marre ne valute jo te konvertueshme nga Pala e pare Kontraktuese, ne perputhje me te drejtat dhe pretendimet e fituara, do te jete lirisht ne dispozicion te Pales se pare Kontraktuese per qellimin e pagimit te cdo shpenzimi te pesuar ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese.

NENI 11

Zbatimi i rregullave te tjera

Nese dispozitat e ligjit te seciles Pale Kontraktuese ose detyrimet sipas te Drejtes Nderkombetare ekzistuese ose te formuluaru ketej e tutje midis Paleve Kontraktuese ne vijim te marreveshjes aktuale permbajne rregulla te pergjitheshme ose te vecanta, qe ua nenshtrojne investimet e shtetasve ose shoqerive te Pales tjeter Kontraktuese nje trajtimi me te favorshem se ai i parashikuar per to nga marreveshja aktuale, te tilla rregulla do te mbizoterojne mbi marreveshjen aktuale ne masen qe ato jane me te favorshme.

NKNI 12

Shtirirja territoriale

Ne kohen kur kjo marreveshje hyn ne fuqi, ose ne cdo kohe pas kesaj, dispozitat e kesaj marreveshje mund te vlejne edhe per territore te tilla, te cilat ne marredheniet e tyre nderkombetare perfagesohen nga Qeveria e Mbreterise se Bashkuar dhe Qeveria e Republikes se Shqiperise, sic mund te bihet dakort midis Paleve Kontraktuese me ane te shkembimit te notave.

NKNI 13

Hyrja ne fuqi

Cdo pale do te njoftoje Palen tjetere Kontraktuese me shkrim per kompletimin e formaliteteve ligjore te kerkuara ne territorin e saj per hyrjen ne fuqi te kesaj marreveshjeje. Kjo marreveshje do te hyje ne fuqi ne daten me te fundit te te dy njoftimeve.

NKNI 14

Kohezgjatja dhe perfundimi

Kjo marreveshje do te qendroje ne fuqi, per nje periudhe prej dhjete vjetesh. Pas kesaj do te vazhdoje te qendroje ne fuqi deri ne skadim per dymbedhete muaj nga data ne te cilen secila nga Palet Kontraktuese do te beje njoftim me shkrim Pales tjetere Kontraktuese per perfundimin e saj. Me kusht qe per investimet e bera nderkohe qe marreveshja eshte ne fuqi, dispozitat e saj do te vazhdojne te veprojne lidhur me investime te tilla per nje periudhe prej njezet vjetesh pas dates se perfundimit dhe pa paragjykim ne zbatimin me tej te rregullave te se Drejtes te Pergjitheshme Nderkombetare.

Me deshmitare te pranishem, te nenshkruarit, pervec kesaj, posacerisht te autorizuar nga Qeverite e tyre respektive, kane nenshkruar kete Marreveshje.

Bere ne dy kopje te njejta ne Londer, dita e tridhjete e muajit mars 1994, ne gjuhet angleze dhe shqipe, te dy tekstet duke pasur fuqi te barbate vepruese.

Per Qeverine
e Mbreterise se Bashkuar te Britanise
se Madhe dhe Irlandes se Veriut:

DOUGLAS HURD

Per Qeverine
e Republikes se Shqiperise:

B. KOPLIKU